



**QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
MINISTRIA E PUNËS DHE E POLITIKËS SOCIALE**

LAJMËRIM

për shfrytëzimin e shërbimit rekreacion klimaterik në banjë për përfituesit e pensionit, për vitin 2018

Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale u bën thirrje të gjithë pensionistëve të interesuar që të paraqiten për shfrytëzimin e shërbimit rekreacion klimaterik në banja.

Këtë shërbim mund ta shfrytëzojnë personat-pensionistët që marrin pension pleqërie, pension invalidor dhe pension familjar që e kanë fituar sipas normave të Republikës së Maqedonisë dhe normave nga marrëveshjet për sigurim social që Republika e Maqedonisë i zbaton, e të cilët jetojnë në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe të drejtën e pensionit e kanë fituar përfundimisht me nëntorin e vitit 2017.

Ky shërbim mund të shfrytëzohet vetëm një herë, në periudhën prej muajit mars deri në nëntor të vitit 2018, në kohëzgjatje prej 7 ditëve.

Shërbimi në fjalë përfshinë:

- 6 pansione të plota (fjetje me tri racione)
- Terapi në banja
- Një kontrollim i obliguar shëndetësor
- Shpenzimet për transport në shumë të biletës kthyesë të autobusit nga vendbanimi i shfrytëzuesit deri te lokacioni ku do të shfrytëzohet ky shërbim (shpenzimet e transportit do të paguhen përmes llogarisë transaktive të shfrytëzuesit të pensionit pas shfrytëzimit të shërbimit).

Pensionistët që shfrytëzojnë edhe kompensime në të holla për ndihmë dhe përkujdesje nga person tjetër, shtesë për mobilitet apo verbësi kanë të drejtë për shoqërues gjatë shfrytëzimit të këtij shërbimi.

Shërbimi i rekreacionit klimaterik realizohet në subjektet juridike të regjistruara për kryerjen e shërbimit për shërim klimaterik në banja, me të cilat Ministria e Punës dhe Politikës Sociale do të lidhë marrëveshje.

Kushtet për shfrytëzimin e shërbimit dhe pikët:

Shërbimin mund ta shfrytëzojnë përfituesit e pensioneve, të cilëve shuma e pensionit për nëntor arrin deri në 17,000 denarë.

Vlerësimi do të bëhet varësisht nga shuma e pensionit prej 1 deri 100 pikë, ku shuma më e ulët e pensionit do të marrë më shumë pikë. Nëse përfituesi i pensionit shfrytëzon pjesë

edhe nga pensioni që i paguhet nga ndonjë shtet tjetër, gjatë vlerësimit do të merret parasysh edhe shuma e pensionit që i paguhet nga shteti tjetër.

Dokumentet e nevojshme që përfituesi i pensionit duhet t'i dorëzojë për shfrytëzimin e këtij shërbimi:

Për shfrytëzimin e shërbimit rekreacion klimaterik në banja pensionistët duhet të parashtrojnë kërkesë në Njësinë rajonale të Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë, sipas vendbanimit të tyre. Kërkesën e jep Njësia Rajonale e Fondit.

Nëse përfituesi i pensionit shfrytëzon edhe pjesë nga pensioni të cilin e merr nga ndonjë shtet tjetër, doemos duhet të parashtrojë edhe çekun nga banka për shumën mujore të pensionit.

Pensionistët të cilët në vitin 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016 dhe 2017 e kanë fituar të drejtën ta shfrytëzojnë shërbimin rekreacion klimaterik në banja apo shërbimin vikend turistik falas, nuk mund të shfrytëzojnë këtë shërbim në vitin 2018.

Kërkesat mund të parashtrohen deri më 16 shkurt të vitit 2018.

Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë me shkrim do ta informojë parashtruesin e kërkesës për entin ku do të dërgohet dhe për periudhën e shfrytëzimit të këtij shërbimi.

Listat e përfituesve të pensionit të cilëve u është miratuar shfrytëzimi i këtij shërbimi do të publikohen në Njësitë Rajonale të Fondit, si dhe në ueb faqen e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale www.mtsp.gov.mk dhe në ueb faqen e Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë www.piom.com.mk

MINISTRIA E PUNËS DHE E POLITIKËS SOCIALE